



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi.org

Nr 182/09 dt. 24. 7 . 2009

Për: Kolegjin UBT

Mbështetur në LAL 2/2003 dhe Udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj: UA 14/2003 për Licencimin e institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë, UA 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, UA 1/2009 për Akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe UA 12/2009 mbi kriteret dhe procedurat për akreditimin e Shkollave të larta profesionale dhe Shkollave të larta teknike në Kosovë), dëshiroj t'ju njoftoj se Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për akreditim dhe ka vendosur si në vijim:

Programet e akredituara

Programet

- Programi menaxhment Biznes dhe Ekonomi (në nivel Bachelor-BSc)
- Programi Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri (në nivel Bachelor-BSc)
- Programi Menaxhim i Mekatronikes (në nivel Bachelor-BSc)

Do të akreditohen për një vit në rastin e parë (1 Tetor 2009-30 Shtator 2010) me kushtet vijuese që duhet plotësuar gjer më 1 Shtator 2009:

1. Të dëshmohet se institucioni posedon burime të mjaftueshme njerëzore (staf akademik vendor) dhe materiale (hapësirë, bibliotekë dhe pajisje për mësimdhënie) për implementimin e programeve të akredituara

2. Të përmirësohet dukshëm furnizimi i bibliotekës me tituj mësimor për lëndët bazike në fushat e ofruara të studimit dhe me revista shkencore në gjuhën angleze

3. Të dorëzohet në AAK Plani i përmirësimit të cilësisë në institucion (follow up) i përpiluar në bazë të rekomandimeve të Ekipit të ekspertëve që duhet të përmbushen gjer në vizitën e ardhshme.

Programet që nuk do të akreditohen

- Programi Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor-(në nivel Bachelor-BSc)

nuk akreditohet dhe nuk duhet të regjistroj studentë të rinj.

Akreditimi institucional

Akreditimi si Kolegj

Ju mund të pranoni studentë në programet e akredituara më lartë që fillojnë më 1 tetor 2009 por nuk mund të pranoni studentë në programet e pa akredituara. Duhet të siguroni se çdo student i pranuar në njërën nga programet e akredituara është regjistruar në njërën prej gradave të ofruara më lartë. Nuk lejoheni që të shpallni konkurs në asnjërin nga programet e pa akredituara, pa marrë parasysh a është specifikuar më lartë apo jo.

Studentët të cilët momentalisht ndjekin studimet në një program të pa akredituar duhet të njoftohen për statusin e akreditimit të programit të tyre para se të regjistrohen në vitin akademik 2009-10

Ju duhet të siguroni se çdo kusht për akreditim i cili është specifikuar më lartë do të plotësohet gjer në datën e caktuar. Ne do të shqyrtojmë përgjigjen tuaj dhe do të vendosim nëse edhe ndonjë vizitë e ekspertëve do të jetë e nevojshme. Nëse po, atëherë të gjitha shpenzimet e bëra do të mbulohen nga ju.

MASHT-i së shpejti do të hartojë një Udhëzim administrativ me të cilin do të kërkon nga ju që të ofroni emrat dhe shënimet tjera personale për

studentë të cilët kanë përfunduar programet e akredituara , së bashku me Shtojcën e diplomës për çdo student, që do të na lejoj ne lëshuarjen e çertifikatës së Diplomës të mbështetur nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës për secilin student që ka diplomuar nga data 7 korrik 2009. Ftoheni që të sjellni te ne sa më parë dizajnin e çdo çertifikate që dëshironi që na ta lëshojmë.

Ju gjithashtu ftoheni që të paraqitni aplikacionin për programme tjera të studimit (pa marrë parasysh a janë paraqitur më heret apo jo). Ne do të jemi në gjendje që të pranojmë këto aplikacione nga 1 Tetori 2009 e tutje. Ju përkujtojmë se të gjitha aplikacionet duhet të plotësojnë kërkesat nga UA 2/2009 ose UA 12/2009.

Studimet master

Qeveria e Republikës së Kosovës dëshiron që t'iu jap një mundësi që të ofroni programet e juaja të akredituara në nivelin master sa më parë që ju jeni në gjendje ta bëni këtë. Nëse dëshironi që ne të shqyrtojmë propozimet e juaja për këto grada, ju lusim që të aplikoni te ne gjer më datën 15 Shtator 2009. Ne do t'iu sigurojmë se aplikacioni i juaj do të shqyrtohet shpejtë dhe ju mund të filloni procesin e regjistrimit për këto grada pasi që KKC i AAK e aprovon aplikacionin tuaj.

Më lejoni që t'ju uroj për marrjen e akreditimit dhe shpresoj që të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen sepse ne punojmë së bashku që të përkrahim përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të lartë në Kosovë.

Prishtinë, 24. 07.2009

Me respekt,
Basri Muja, u.d. Drejtor

